



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ___/___/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: „Erisoni Company” shpk

1.1 Procedura e prokurimit: “Kërkesë Për Propozime-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

1.2 Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-71743-05-28-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje Tонера për nevoja të Shoqërisë**” me fond limit 5.199.986 (pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa t.v.sh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike ,

1.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Erisony Company sh.p.k**

K92006501A

Vlera 3.839.700(tre milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind)lekë pa tvsh.

2. **Infosoft Office sh.p.k**

J62426002Q

Vlera 4.991.831(katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e një)lekë pa tvsh.

3. Gjergji IT sh.p.k

K81503063B

Vlera 4.067.060(katër milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Gjergji IT sh.p.k

K81503063B

Vlera 4.067.060(katër milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar pika 4:

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specififikimet teknike është kusht për skualifikim.Në specififikimet teknike në DST është kërkuar bojërat duhet të jenë origjinale,jokompatible ,të mos jenë të rimbushura ,të mos jenë të ricikluara,të mos jenë të riprodhuara ,të jenë të paketuara ,të pahapura.

Tonerat të jenë të shoqëruara me pullë sigurie nga prodhuesi .

Emri i prodhuesit të jetë i stampuar si në kutinë e bojës ,në pullën e sigurisë si dhe në kartrixhe.

Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.

Gjatë shqyrtimit dhe kontrollit të mostrave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nëse mostrat e dorëzuara përkojnë me specififikimet teknike të përcaktuara në DST u konstatua se mostrat përkatësisht zërat e preventivit nr.11 e cila përkon “Xerox Phaser 3330(**106R03621**)”rezultuan të mos jenë në përputhje me specififikimet teknike konkretisht nuk përputhej numri part-number i kërkuar nga ana e AK.

Rrjedhimisht mostra e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik nuk përmbush specififikimet e kërkuara nga AK.

Gjithashtu u vu re dhe nga mungesa e një prej mostrave HP82 ngjyrë magenta e cila është pjesë e setit prej 4 tonerash(Black,Yelloë,Magenta,dhe Cyan).

Vlen të theksojmë se mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK si dhe mungesa e njëres prej mostrave të kërkuara nuk garanton A.K UKT sh.a se operatori i “IT Gjergji Computer” sh.p.k realizon kontratën me sukses objekt prokurimi në rast se do shpallej fitues.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në tender, pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga operatori ekonomik Infosoft

Office ”sh.p.k hyrë në UKT sh.a me nr. Prot 22377,datë 27.09.2018, në lidhje me vlerësimin e kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Me marrjen e ankesës së operatorit të mësipërm në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në VKM-në Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, Kreu X, Neni 78, pika 2, me Urdhërin nr. 9747/9 datë 17.05.2018, u pezullua procedura sipas legjislacionit në fuqi, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP.

Gjithashtu në mbështetje të pikës 6/a të Kreut X të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar me urdhër nr.24492/20 datë 27.09.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave i cili pasi u njoh me pretendimet e operatorit ekonomik “**Infsoft Office ” shpk**, konkludoi në mos pranimin e ankesës.

Më datë 11.10.2018 operatori ekonomik ka ankimuar vendimin e AK pranë KPP.

Me anë të vendimit nr.783/1 Prot,KPP vendosi mospranimin e ankesës, si dhe lënien në fuqi të vendimit të AK.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **21.09.2018**

Ankesa:PO(Ankesë e paraqitur nga operatori ekonomik ”Infsoft Office ” sh.p.k i cili i është kthyer përgjigje më datë 03.10.2018,prot 22377/1

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Erisony Company**”se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.839.700(tre milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind)lekë pa tvsh. pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ë procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **21.09.2018**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Redi MOLLA

